



/K. A. Nr. 3/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 09.04.2025

Nr. 2747 prot.

Lënda: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ
Drejtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Të nderuar anëtarë të KAS,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 24 ID më datë 21.02.2025, depozituar nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

Në këtë denoncim KRIIK pretendon si vijon:

"Më datën 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inagurimin e Kopshtit nr.74, "Luleborë". Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant zj. Zhaneta Beqiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve. Aktiviteti është transmetuar live në median televizive dhe në faqen Facebook të Kryetarit të Bashkisë, z. Veliaj, nga ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Palrent Ndreca dhe Zj. Ermonela Felaj".

Me vendimin nr. 135, datë 22.05.2025, të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), vendosi fillimin e procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi.

Në mbështetje të përcaktimit të nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ.

Bazuar në këtë vendim iu kërkua personave përgjegjës pranë Kuvendit të Shqipërisë, për raportimin e veprimtarive publike, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Neni 92, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se: *"Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre."*



Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, nenet 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, i propozoj Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- z. Alban Dokushi, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Tiranë, në vlerën 1 000 (njëmijë) lekë, referuar nenit 171, pika 2, e Kodit Zgjedhor.

Nga të dhënat që disponohen rezulton se subjektet nuk janë përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 448, datë 08.04.2025, “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 24 ID, datë 21.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK”;
- Denoncim nr. 24 ID, datë 21.02.2025, depozituar nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK”;
- Korrespondenca elektronike, me subjektin denoncues Bashkia Tiranë dhe KRIIK .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.04.2025

Nr: 448

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME
NR. 24 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK

Sot më datë 08.04.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/
KRIIK

SUBJEKT: Zj. Zhaneta Beqiri

Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve,
Bashkia Tiranë

Z. Alban Dokushi

Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Tiranë

OBJEKT: Lidhur me raportimin e paplotë të një veprimtarie nga ana e Drejtorisë së
Kopshteve dhe Çerdheve Tiranë dhe përdorim i burimeve publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n” dhe neni 92, të ligjit
nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,
të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 08.04.2025

Nr: 448

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me
nr. 24 ID, datë 21.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të
Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të
Konsoliduara/KRIIK”

KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK, më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 24 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Më datën 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inagurimin e Kopshtit nr.74, “Luleborë”. Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Veliq, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant zj. Zhaneta Beqiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve. Aktiviteti është transmetuar live në median televizive dhe në faqen Facebook të Kryetarit të Bashkisë, z. Veliq, nga ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Plarent Ndreca dhe zj. Ermonela Felaj”.

Me vendimin nr. 135, datë 22.05.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, duke i'u kërkuar personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 27.02.2025, KQZ, administroi pretendimet e Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë, të dërguara me e-mail në KQZ. Sipas këtyre pretendimeve:

“Ky aktivitet si dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje me inagurimet e çerdheve dhe kopshteve publike të Bashkisë Tiranë, janë evente që organizohen nga Bashkia Tiranë, përkatësisht Drejtoria e Protokollit dhe e Ceremonialit Zyrtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, person juridik më vete, por institucion varësie e Bashkisë Tiranë në këto evente flet si pjesëmarrës. Konkretisht, në eventin objekt ankimi, titullari i institucionit është njoftuar për eventin nëpërmjet emailit më datë 07.02.2025, ora 14:15 (bashkëlidhur). Duke qenë se titullari i institucionit do të merrte pjesë në inagurim, në zbatim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 datë 24.12.2020, të KQZ-së është raportuar nga ana jonë pjesëmarrja e titullarit.”

Nëpërmjet postës elektronike, më datë 04.03.2025, KSHZ, i ka kërkuar personit përgjegjës për Administratën e Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë, të vendosë në dispozicion provat e plota që disponon mbi këtë procedurë.

Më datë 05.03.2025, KQZ administroi provat e Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë, të dërguara me e-mail në KQZ. Sipas këtyre provave:

“Konkretisht, aktiviteti mbi inagurimin e kopshtit Nr.74 “Luleborë” na është bërë me dije nga komunikimet e vazhdueshme me Bashkinë Tiranë, si dhe nëpërmjet postës elektronike drejtuar titullarit nga asistenti i Drejtorit të Kabinetit të Bashkisë Tiranë. Në emailin e sipërpërmendur përcaktohet:

Data: 08.04.2025

Nr: 448

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 24 ID , datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”

Ju njoftoj se ditën e Hënë, më datë 10 Shkurt, ora 10:00 do të zhvillohet "Event i inagurimit të Kopshtit nr. 74 Luleborë".

Në kuadër të hetimit administrativ, pas zhvillimit të seancës publike të datës 07.03.2025, dhe pasi u dëgjuan pretendimet e përfaqësueses të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve, e cila vendosi në dispozicion ftesën e bashkisë Tiranë, si institucion organizator i kësaj veprimtarie publike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkoi personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë, të paraqesin pretendime në lidhje me çështjen objekt hetimi administrativ.

Më datë 10.03.2025, kemi administruar përgjigjen e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë, i cili bën me dije se:

"Për sa i përket pranisë së dy deputetëve në inagurimin e Kopshtit nr. 74, "Luleborë", theksojmë se për raportimin në fjalë nuk ka qenë e parashikuar pjesëmarrja e dy deputetëve por është vendosur aty për aty duke e bërë të pamundur modifikimin e eventit të raportuar, përfshirë këtu edhe problematikat e sistemit në atë periudhë".

Gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se veprimtaria publike është raportuar, në datë 05.02.2025, elektronikisht nëpërmjet adresës e-mail të KQZ-së, për shkak se në sistemin e ndërfaqes elektronike ishin duke u kryer disa përditësime.

Organizatori i veprimtarisë publike sikurse pranohet edhe nga përfaqësuesi i bashkisë është Bashkia Tiranë.

Evidentohet fakti se prania e dy deputetëve në aktivitetin e zhvilluar nuk është njoftuar paraprakisht nga organizatorët e aktivitetit publik, gje që bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

Për këto arsye, vlerësoj se gjatë hetimit administrativ, u arrit të provohej shkelja e nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe pika 5, e nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj referuar nenit 171, pika 2, të Kodi Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenin 92, pika 1, nenin 171, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenin 5, pika 5, të vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

Data: 08.04.2025

Nr: 448

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 24 ID, datë 21.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK"

VENDOS:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative ndaj z. Alban Dokushi, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Tiranë, në vlerën 1 000 (një mijë) lekë.
2. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj zj. Zhaneta Beqiri, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 08.04.2025

Nr: 448

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 24 ID , datë 21.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK"

By Date

Mon 11:42 AM

Mon 11:41 AM

Mon 11:14 ...

Mon 11:14 ...

Mon 11:10 ...

Mon 11:07 ...

Fri 4/4

Fri 4/4

Fri 4/4

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. **24 ID**

denoncime

To: Alban Dokushit, nensalbardha@tirana.al, Zhaneta Begiri

Cc: info@krik.al

Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Friday, February 21, 2025 1:46:15 PM

To: Blerina Spahiu

Cc: info@krik.al

Subject: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. **24 ID**

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 19.02.2025, është administruar denoncimi regjistruar me nr. **24 ID**, i përcjellë nga Koalicioni për Reforme, Integritim dhe Institucione të Re.

Në këtë denoncim KRRIK parashtrohet sa vijon:

“Më datën 10 shtator 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inaugurimin e Kopshtit nr. 74, “Luleborë”. Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant zj. Zhaneta Begiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Gerdheve. Aktiviteti është transmetuar nës **24** dhe në faqen Facebook të Kryetarit të Bashkisë, z. Veliaj, nga ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. P. Felaj.

Së pari, në gjykimin e KRRIK pjesëmarrja e dy deputetëve në një event të organizuar me fonde publike, përbën përdorim të burimeve shtetërore për përfitim elektoral nga deputetët, përfaqësues të Partisë Socialiste e Shqipërisë si dhe çënon garën zgjedhore.

Së dyti, KRRIK denoncon Administratën e Kopshteve dhe Gerdheve, në Bashkinë Tiranë për raportim të pjesshëm të aktivitetit, pasi prania e dy deputetëve në aktivitetin e zhvilluar sipas pikës 5, të nenit 5 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator të ndryshuar”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi denoncimin e administruar.

Bazuar në nenin 91 dhe 169 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative, kërkohet nga ana juaj, lidhje me denoncimin që i përket institucionit Tujaj, brenda 48 (dyzetë e tetë) orëve.

Bashkëlidhur po ju vërmë në dispozicion denoncimin e administruar nga ana jonë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



24 ID

View Help Search

Subject Has Attachments Unread Categorized Flagged Important Include Deleted Items Close Search ...

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

denoncime

To: Alban Dokushi, nensibardha@tirana.al, Zhaneta Beqiri

Cc: info@kritik.al

Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

me ngrazi te vjures te rekurrit qd imituarat ju lutem ne ngraziti nga ju, te vjures ne dispozicioni juve qd putat qd uaputur n ngraziti.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Monday, March 3, 2025 5:00 PM

To: Blerina Spahiu <blerina.spahiu@tirana.al>

Cc: Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

Pershendetje,

Ju lutem na vendosni ne dispozicion ftesen e organizuesit te kesaj veprimtarie publike.

Faleminderit.

From: Blerina Spahiu <blerina.spahiu@tirana.al>

Sent: Friday, February 21, 2025 2:15 PM

To: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Cc: Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

KUDES: Ky eshte një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-te ose bashkelidhjet nese nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni derguesit. Pershendetje te nderuar,

Në lidhje me aktivitetin mbi inagurimin e kopshtit Nr.74 "Luleborë", ju bëjmë me dije se, ky aktivitet dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje me inagurimet e gerdheve dhe kopshteve publike të organizohen nga Bashkia e Tiranë, përkatësisht Drejtoria e Protokollit dhe e Ceremonialit Zyrtar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gerdheve dhe Kopshteve, person juridik më vete, por Institucion varësle e Bashkisë Tiranë në këto evente ftohët si pjesëmarrës. Konkretisht, në eventin objektiv ankim njoftuar për eventin nëpërmjet emailit më datë 07.02.2025, ora 14:15 (bashkëlidhur). Duke qenë se titulli i institucionit do të merret pjesë në inagurim, në zbatim të nentit 92 të kodit zgjedhor të KOZ-së është raportuar nga ana jonë pjesëmarrja e titullarit. Bashkëlidhur do të gjëni ftesën e sipërcituar dhe komunikimet.

Faleminderit!

By Date

Mon 11:42 AM

Mon 11:41 AM

Mon 11:14 ...

Mon 11:14 ...

Mon 11:10 ...

Mon 11:07 ...

Fri 4/4

Fri 4/4

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin n.r. 24 ID

D

denoncime

To: Alban Dokushit, nensi.bardha@tirana.al, Zhaneta Beqiri
Cc: info@kritikal

Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Iancce

Në këtë bashkëdhur do të gjeni:

1. emailin e ftesës
2. Memon e eventit sipërpërmendur, atashuar në email, pika 1.
3. Relacion inagurimi kopsit Nr.74 "Luleborë", atashuar në emailin, pika 1.
4. Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve
5. Rregullore e Bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al/kategoria-e-publikimit/2022-1136>

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin mbeteni në dispozicionin tuaj për çdo informacion të mëtejshëm!

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Tuesday, March 4, 2025 12:37:00 PM

To: Blerina Spahu

Cc: Zhaneta Beqiri

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin n.r. 24 ID

Përshtendetje,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zhvilloi seancën publike mbi denoncimin e administruar nga ana jonë për Institucionin Tuaj.

Në kuadër të vijimit të hetimit administrativ ju lutem kërkojmë nga Ju, të vendosni në dispozicion provat e plota që dispononi mbi këtë procedurë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

By Date

Mon 11:42 AM

Mon 11:41 AM

Mon 11:14 ...

Mon 11:14 ...

Mon 11:10 ...

Mon 11:07 ...

Fri 4/4

Fri 4/4

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

denoncime

To: Alban Dokushit, nensibardha@tiranai, Zhaneta Beqiri

Cc: info@nri-ai

Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamece

From: Blertina Spahiu <blertina.spahiu@tiranai>

Sent: Wednesday, March 5, 2025 10:35 AM

To: denoncime <denoncime@nri.gov.al>

Cc: Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tiranai>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

KUJDES: Ky eshte nje email i ardhur nga jashte adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-te ose bashkelehdhet nese nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni derguesit. Pershendetje te nderuar,

Në vijim të ankesës së Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK, administruar në KOZ Nr.24ID, datë 19.02.2025, si dhe në vijim të komunikimeve tona të mëpa Nr.287 Prot, datë 21.02.2025 si dhe Nr.287/1 Prot, datë 21.02.2025, ju informojmë si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, person juridik me NIPT K517160475 në zbatim të rregullores së institucionit miratuar me Urdhërin e K ofron dhe monitoron shërbimin në çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë.

Për sa më sipër, DPÇK nuk kryen investime infrastrukturore, por në vijim të planifikimeve të Bashkisë Tiranë për hapjen e institucioneve të reja bashkëpunon dhe koordinon punën për ofrimin përmes një misioni për mirëritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe parimit të interesit më të lartë të fëmijëve. Konkretisht DPÇK merr masat për rekrutimin e stafit, furnizimin me ushqim, enë dhe mjete didaktike, etj, si dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e përditshëm të çerdheve dhe kopshteve.

Në këtë kuadër, për sa i përket aktiviteteve për hapjen dhe inagurimin e çerdheve dhe kopshteve të reja, DPÇK pasi njoftohet nga Bashkia Tiranë dhe koordinon punën e përshtatshme me Bashkinë Tiranë.

Konkretisht, aktiviteti mbi inagurimin e kopshtit Nr.74 "Luleborë" na është bërë me dije nga komunikimet e vazhdueshme me Bashkinë Tiranë, si dhe nëpërmjet postës elektronike drejtuar të Kabinetit të Bashkisë Tiranë. Në emailin e sipërpërmendur përcaktohet:

Ju njoftoj se ditën e Hënë, me datë 10 Shkurt, ora 10:00 do të zhvillohet "Event i inagurimit të kopshtit nr. 74 Luleborë".

Në këtë event do të jenë të ftuar:

- Drejtoresha e Kopshteve dhe Çerdheve Znj. Zhaneta Beqiri

Gjithashtu, në këtë email është bashkëlidhur MEMO eventit ku përshkruhet rendi i aktiviteteve dhe përcaktohet se:

10:10 - Fjala e hapjes për Drejtorin e Përgjithshëm të Çerdheve dhe Kopshteve, Znj. Zhaneta Beqiri;

Duke qenë se titullari i institucionit do të marrë pjesë në inagurim dhe do të mbante fjalën e saj në këtë event publik, në zbatim të nenit 92 të kodit zgjedhor dhe vendimit nr.9 datë 24.12.20 ana jonë pjesëmarrja e titullarit (i ftuar në këtë event).

By Date v ↑

Mon 11:42 AM



denoncime

To: ● Alban Dokushi, ● nensi.bardha@tirana.al, ● Zhaneta Begiri
Cc: ● info@krrrik.al

Bcc: ● Pavlina Docaj, ● Aurel Lamce

Pershendetje.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 19.02.2025, është administruar denoncimi regjistruar me nr. **24 ID**, i përcjellë nga Koalicioni për Reformë, Integritet dhe Institucione të Konso-

Në këtë denoncim KRRRIK, parashtron sa vijon:

"Më datën 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inaugurimin e Kopshtit nr. 74, "Luleborë". Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Velaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant z. Zhaneta Begiri, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdhëve. Aktiviteti është transmetuar L **24** dhe në faqen Facebook të Kryetarit të Bashkisë, z. Velaj, nga ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Plarenti Ndre Së pari, në gjykimin e KRRRIK pjesëmarrja e dy deputetëve në një event të organizuar me fonde publike, përben përdorim të burimeve shtetërore për përfundim elektoral nga deputetët dhe jo Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe cenon garën zgjedhore.

Së dytë, KRRRIK denoncon Administratën e Kopshteve dhe Çerdhëve, në Bashkinë Tiranë për raportim të pjesshëm të aktivitetit, pasi prania e dy deputetëve në aktivitetin e zhvilluar nuk të pikës 5, të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator të ndryshuar".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi denoncimin e administruar.

Duke qenë se nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdhëve dhe Kopshteve deklarohet se eventit është organizuar nga ju duke cituar si me poshte vijon:

Ju njoftoj se ditën e Hënë, më datë 10 Shkurt, ora 10:00 do të zhvillohet "Event i inaugurimit të Kopshtit nr. 74 Luleborë".

Në këtë event do të jeni të ftuar:

- Drejtoresha e Kopshteve dhe Çerdhëve Znj. Zhaneta Begiri

Gjithashtu, në këtë email është bashkëlidhur MEMO eventit ku përshkruhet vendi i aktivitetit dhe përcaktohet se:

10-10 - Fjala e hapjes për Drejtorin e Përgjithshëm të Çerdhëve dhe Kopshteve, Znj. Zhaneta Begiri;

Duke qenë se titullari i institucionit do të merrte pjesë në inaugurim dhe do të mbante fjalën e saj në këtë event publik, në zbatim të neni 92 të kodit zgjedhor dhe vendimit nr.9 datë **24.12.2025** ana jone pjesëmarrja e titullarit (1 fuar në këtë event)";

kërkojme brenda dites se sotme informacione saktëse nga ana juaj me lidhje me raportimin e kësaj veprimtarie publike.

Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion denoncimin e administruar nga ana jone si dhe cdo komunikim elektronik qe kemi zhvilluar ne kuader te hetimit administrativ.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Q Search



By Date

Mon 11:42 AM

Mon 11:41 AM



denoncime
To: Alban Dokushi, nensibardha@tirana.al, Zhaneta Beqiri
Cc: info@kritik.al
Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, March 27, 2025 10:03 AM

To: Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al>; Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>;
Cc: info@kritik.al <info@kritik.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

Përsënderëjta,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi vijimin e hetimit administrativ të shtyrë nga seanca publike e datës 21.03.2025.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegime 21 Mars 2025, ora 12:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, March 20, 2025 10:38 AM

To: Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al>; Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>;
Cc: info@kritik.al <info@kritik.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

Përsënderëjta,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi vijimin e hetimit administrativ të shtyrë nga seanca publike e datës 07.03.2025.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegime 21 Mars 2025, ora 12:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

By Date

Mon 11:42 AM

Mon 11:41 AM

Mon 11:14 ...

Mon 11:14 ...

Mon 11:10 ...

Mon 11:07 ...

Fri 4/4

Fri 4/4

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Wed 4/2

Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

denoncime

To: Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al> Zhaneta BeqiriCc: info@krik.al

Bcc: Pavlina Docaj, Aurel Lamce

Përsëritje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka përfunduar hetimin administrativ ndaj Institucionit Tuj dhe do të vijojë me shpalljen e vendimit për denoncimin regjistruar me n. Shpallja e vendimit do të bëhet ditën e martë, më datë 08 Prill 2025, ora 12:00, në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, March 27, 2025 10:05 AM

To: Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al> nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al> Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>Cc: info@krik.al <info@krik.al>

Subject: Re: Kerkese per depozitim pretendimesh mbi denoncimin nr. 24 ID

Ndjeshe te emaili i derguar pak me pare ka nje gabim material ne lidhje me daten dhe oren se kur do te zhvillohet seanca, **ju lutem merrni ne reference kete email.**

Përsëritje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi vijimin e hetimit administrativ të shtyrë nga seanca publike e datës 21.03.2025.

Mbështetur në përaftimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegime 28 Mars 2025, ora 13:00, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, March 27, 2025 10:03 AM

To: Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al> nensibardha@tirana.al <nensibardha@tirana.al> Zhaneta Beqiri <zhaneta.beqiri@tirana.al>Cc: info@krik.al <info@krik.al>



Koalicioni për Reformë, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara
Coalition for Reform, Integration
and Consolidated Institutions

Contact: Mobile/WhatsApp: +355686609338, 682039297 | Email: info@kriik.al, info.kriik@gmail.com | Web: www.kriik.al | Facebook: <https://www.facebook.com/kriik.al>



Nr. 2502/017 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 19/02/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI
Komisionit të Ankimimeve dhe
Sanksioneve

Lënda: DENONCIM Nr. 13 – Lidhur me
raportimin e pa plotë të një veprimtarie
nga ana e Drejtorisë së Kopshteve dhe
Çerdheve, Bashkia Tiranë.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!

Në datë 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë, Njësia Administrative Kashar (në adresën : Rruga "Sadik Stavileci", Nd. 16 H, Kashar-Katund i Ri, Tiranë, një aktivitet për inaugurimin e Kopshtit nr. 74 "Luleborë".

Sipas raportimit të institucionit përkatës në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së (shih Lidhjen 1, pika III), eventi organizohej nga Administrata e Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Tiranë, me folës kryesor Kryetarin e Bashkisë Tiranë, z. Erjon Veliaj dhe pjesëmarrës të nivelit të lartë, jo diskutant, znj. Zhaneta Beqiri, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve. Referuar raportimit nuk kishte të tjerë diskutantë apo pjesëmarrës të nivelit të lartë në event.

Aktiviteti i zhvilluar, referuar transmetimit LIVE në median televizive TV News24 si dhe [videos](#) së transmetuar LIVE në facebook-un e Kryetarit të Bashkisë z. Erion Veliaj, pati pjesëmarrës në cilësinë e folësve edhe dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Plarent Ndreca dhe znj. Ermonela Felaj. (shihni për më shumë Lidhjen 1, pika I e II).

Së pari, vendosim në dukje se pjesëmarrja si folës e dy deputetëve në një event institucional të organizuar nga një institucion publik në varësi të Bashkisë Tiranë, titullari i të cilës është zgjedhur si kandidat i të njëjtës forcë politike me deputetët, në periudhën katër muaj para zgjedhjeve, në gjykimin e KRIIK, përbën përdorim të burimeve shtetërore për përfitim elektoral nga deputetët në fjalë dhe forca politike që ata përfaqësojnë, Partia Socialiste e Shqipërisë, si dhe cënon barazinë në garën zgjedhore.

Kjo pasi pjesëmarrja e tyre në një event të tillë, të organizuar me fonde publike sjell një përfitim politik të drejtpërdrejtë në favor të tyre dhe Partisë Socialiste, duke e paraqitur projektin si një arritje të partisë dhe jo si një investim të financuar nga taksapaguesit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj. Adm 5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Për analogji, kujtojmë se sipas pikës 3 të nenit 81 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, "Transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i

institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektoral të subjektit zgjedhor."

Pra referuar këtij përkufizimi, është e qartë se vullneti i legjislatorit në hartimin e Kodit Zgjedhor ka qenë se eventet që synojnë promovimin e arritjeve institucionale, investimet apo inaugurimet ndjekin qëllime elektorale.

Së dyti, nga një pikëpamje formale, vëmë në dukje se **prania e dy deputetëve në aktivitetin e zhvilluar nuk është njoftuar paraprakisht nga organizatorët e eventit, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 5 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator**, sipas të cilit "Raportimi duhet të përmbajë, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, qëllimin dhe tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përket, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo.

Pika 1 e nenit 10 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, përcakton se "Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, **KRIIK denoncon Administratën e Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë për raportim të pjesshëm të aktivitetit të zhvilluar në datën 10 shkurt 2024 dhe i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të veprojë sipas parashikimeve të ligjit.**

Në gjykimin e KRIIK, KQZ-ja nevojitet që përpos sanksionimit të titullarit përkatës të institucionit, të njoftojë dhe paralajmërojë me shkrim Partinë Socialiste të Shqipërisë në favor të së cilës është kryer shkelja e mësipërme, duke i kërkuar marrjen e masave nga ana e saj për disiplinimin e deputetëve si dhe të përfaqësuesve politikë të saj për mos-përsëritjen e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.

Gjithashtu, nxitet KQZ-ja t'i dërgojë një informacion të detajuar mbi këtë ngjarje Kuvendit të Shqipërisë, për tu tërhequr vëmendjen Deputetëve dhe për të parandaluar në të ardhmen përdorimin e aktiviteteve institucionale për avantazh elektoral prej tyre.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforme, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gago
Kryetar**

Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj. Adm.5,
Tirana
Mailing address:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhja nr. 1

I. PASQYRIMI I AKTIVITETIT NË MEDIA

- TV FAXNEWS



- TV NEWS24



Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj. Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box, 2396
Tirana, 1001,
Albania

II. POSTIMI NË FAQEN ZYRTARE NË FACEBOOK TË KRYETARIT TË BASHKISË TIRANË Z. ERION VELIAJ

Kopshti i ri që hapëm sot në Yzberisht është një tjetër punë konkrete, që u vjen në ndihmë prindërve dhe fëmijëve të zonës, të cilët tani do të mësojnë në kushte shumë më të mira. I gëzohem faktit se ky është kopshti/çerdhja jonë e 110 që çelim në Tiranë, si vijim i transformimit të objekteve arsimore.



Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, Il.2, Ap.3,
Nj. Adm.5,
Tirana

Mailing address:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

KOMISIJA ZA ČOVJEČANSKE PRAVA

Address:
Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:
P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

